




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI



URDHËR

Nr. 239 , datë 16.12.2024

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Struktura e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike të jetë, gjithsej, 85 veta.
4. Urdhri nr.233, datë 20.12.2023, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

STRUKTURA E AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

